



Prishtinë, 30 tetor 2009
Kodi i ZRRE-së: V_206_2009

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna në nenin 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-080;
2. Dispozitat e Ligjit për Energjinë nr. 2004/8;
3. Bashkërendimin e të Ardhurave të lejuara me ato të realizuara për sezonin e ngrohjes 2008/2009, të Ngrohtores së Qytetit (NQ) Gjakova SH.A.
4. Paqëndrueshmërinë e çmimit të importit të lëndës djegëse – mazutit, si pasojë e lëvizjeve të çmimit të naftës në bursat ndërkombëtare, i cili çmim ndikon dukshëm në koston totale të afarizmit të ndërmarrjes; dhe
5. Qëllimin që të sigurohet stabilitet i tarifave të ngrohjes qendrore, që do të reflektojnë koston reale dhe të arsyeshme të prodhimit dhe furnizimit me ngrohje qendrore.

Në mbledhjen e mbajtur me datë 30 tetor 2009, nxori këtë:

VENDIM

1. **APROVOHEN** tarifat për NQ Gjakovë SH.A. për sezonin e ngrohjes 2009/2010, siç janë paraqitur në tabelat "A" dhe "B".

TARIFAT PËR NGROHTOREN E QYTETIT GJAKOVË SH.A. PËR SEZONIN E NGROHJES 2009/2010
--

Tabela A. TARIFA PËR KONSUMATORËT PA MATJE

NGROHTORJA E QYTETIT GJAKOVË SH.A.		
Komponentet e Tarifave	Konsumatorët shtëpiakë	Konsumatorët Komercialë e Institucionalë
Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse)	0.13 [€m ² për muaj]	0.17 [€m ² për muaj]
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	0.77 [€m ² për muaj]	1.11 [€m ² për muaj]

Tabela B. TARIFA PËR KONSUMATORËT ME MATJE

NDËRMARRJA E NGROHJES QENDRORE "GJAKOVA" NGROHTORJA E QYTETIT GJAKOVË SH.A.	
Tarifa mujore e kapacitetit të ngrohjes (komponenta fikse)	1.33 [€kW për muaj]
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	47.62 [€MWh]



2. Tarifat e aprovuara do të publikohen nga NQ Gjakova SH.A. në njërin nga gazetat ditore me qarkullim më të gjerë në Kosovë, brenda pesë ditëve të punës, pas shpalljes dhe publikimit të vendimit nga ana e ZRRE-së në faqen elektronike zyrtare të saj.
3. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) do të përdorë të drejtat sipas ligjit, auditojë regjistrat e kontabilitetit dhe faturat e tyre, me qëllim për të verifikuar të dhënat e paraqitura nga NQ Gjakova SH.A të nevojshme për bashkërendim dhe përcaktim të tarifave.
4. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe;
5. Ky Vendim hyn në fuqi datën e aprovimit të tij nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Gjykatën e juridiksionit përkatës brenda 14 ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, cilado të ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Dr. Ali Hamiti, Kryesues,

Theranda Beqiri, Anëtare

Dr. Nysret Avdiu, Anëtar

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar